⁶ Te dhënat për komunën Zajas, Oslomej, Drugovë, Vraneshnicë janë të viti 2012 dhe janar-prill të viti 2013, gjegjësisht deri në bashkangjitje me Kërçovën.

2. Metodologjia

Në periudhën janar-mars 2014 Fondacioni për zhvillim të bashkësive lokale –Shtip, Qendra për zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit - Dibër, Qendra për zhvillim të bashkësive - Kërçovë, dhe Qendra kulturore rinore - Manastir, realizuan aktivitete për mbledhjen e të dhënave për verifikimin e gjendjes së praktikave financiare dhe buxhetore të NJVL për ndarjen e mjeteve për shoqata për vitet 2012 dhe 2013 në 15² komuna në Republikën e Maqedonisë, edhe atë: Shtip, Karbinci, Koçan, Ceshinovë-Obleshevë, Kërçovë (së bashku me komunat e bashkangjitura Zajas, Oslomej, Drugovë e Vraneshnicë)⁷, Pllasnicë, Makedonski Brod, Dibër, Mavrovë — Rostushë, Qendër Zhupë, Strugë, Manastir, Mogilë, Novaci, dhe Demir Hisar.

Zgjedhja e komunave është bërë sipas karakteristikave: rajoni, madhësia, principi urban/rural, përfaqësia etnike e banorëve.

Në katër rajonet (Shtip, Kërçov, Dibër dhe Manastir) mbledhja e informatave u realizua nga 4 koordinatorë lokal sipas pyetësorit⁸ të parapërgaditur me pyetje dhe sipas një plani të definuar për implementim.

Mbledhja e informatave realizohej nëpërmjet kontakteve me kryetarët e komunave, takime me të punësuarit në administratë të autorizuar për kontakte me shoqatat dhe nga njësia për buxhet dhe financa dhe punëve juridiko-normative. Të dhënat u mbledhën edhe nëpërmjet qasjes në dokumentat e komunës (buxhetit, llogarisë përfundimtare) dhe përdorimit të Ligjit për qasje të lirë tek informatat me karakter publik, nëpërmjet kërkesave të definuara me ligj.

Me qëllim që të vërtetohet gjendja e NJVL për praktikën buxhetore dhe financiare për shpërndarjen e mjeteve, si dhe vërtetimin e sfidave në procedura, të dhënat e fituara kanë të bëjnë me mjetet e planifikuara dhe ata të transferuara nga kategoria buxhetore transfere tek shoqatat nga buxhetet komunale si dhe përqindja e mjeteve të cilat janë të planifikuara dhe të transferuara nga buxheti i përgjithshëm i komunave, lartësia mesatare e mjeteve të shpërndara shoqatave, mënyra e shpërndarjes së mjeteve (konkurs publik, kritere të shkruara); sferat e veprimit të shoqatave.

Të dhënat e mbledhura⁹ nga komunat janë distribuar tek shoqatat lokale në të katër rajonet (Shtip, Kërçovë, Dibër dhe Manastir). Komentet, përfundimet dhe rekomandimet prej shoqatave janë të inkuorpuara në dokument.

⁷ Te dhënat për komunën Zajas, Oslomej, Drugovë, Vraneshnivë janë të viti 2012 dhe janar-prill të viti 2013, gjegjësisht deri në bashkangjittje me Kërçovën

⁸ E bashkangjitur në publikim është edhe pyetësori.

⁹ Të dhëna detale për komunat janë prezentuar në Annex 1 në kornizat e publikimit.

3. Analiza

Prej të dhënave të prezantuara në këtë publikim shihet qartë se komunat çdo vit buxhetojnë mjete në kategorinë Transfer tek OJQ prej buxheit komunal, por egziston dallim në mes mjeteve të planifikuara dhe transfereve reale tek shoqatat (tabela nr.5). Kjo tregon se komunat këtë kategori buxhetore e ruajnë si sigurim me të cilën mbulohen shpenzimet tjera dhe gjatë rebalansit të parë të buxhetit kjo kategori gjithmonë zvogëlohet.

E dhëna se më pak se 1% prej buxhetit të komunave të përfshira me këtë analizë u është transferuar shoqatave, tregon se interesi i komunave për bashkëpunim me shoqatat rreth pyetjeve të rëndësishme që kanë të bëjnë me përmirësimin e kushteve të jetës në komunë, akoma nuk është në nivel të dëshirueshëm dhe shoqatat nuk kategorizohen si aktorë të rëndësishëm dhe partnerë afatgjatë në procesin e zhvillimit të bashkësisë nga ana e Njësive të vetqeverisjeve lokale.

Në vitin 2013 komunat u kanë transferuar më pak mjete shoqatave sesa në vitin 2012 (Tabela nr.4). Kjo lidhet me mbajtjen e zgjedhjeve lokale në vitin 2013, gjegjësisht ndërimin në përbërjen e këshilltarëve të zgjedhur dhe kryetarëve, të cilët siç duket përkrahjen e shoqatave prej buxhetit të komunës nuk e vendosin si prioritet, as edhe si sfidë për rritjen e kategorisë dhe përparimin e bashkëpunimit me sektorin civil në bashkësi.

E dhëna se lartësia mesatare e granteve të dhëna prej komunave për organizata lëviz në lartësinë prej 10 000,00 deri 50 000,00 MKD (Tabela nr.6) tregon se komunat ndajnë mjete për përkrahjen e shoqatave për aktivitete afatshkurtëra ose për përkrahjen e ngjarjeve ose aksioneve dhe nuk kanë qasje strategjike për bashkëpunim afatgjatë.

Numri më i madh granteve prej buxheteve të komunave u janë ndarë shoqatave të cilat veprojnë në sferën e kulturës dhe artit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut si dhe përkrahje për harxhime operative të shoqatave. (Tabela nr.7).

Vetëm 4 komuna kanë bërë transfer tek shoqatat prej linjave të tjera buxhetore nga buxheti komunal. Buxheti i përgjithshëm i të gjitha transfereve nga linjat tjera është 502 135,00 MKD. Megjithatë, në asnjërën prej komunave nuk egziston transfer i kompetencave prej komunës tek shoqatat. Edhe pse, më shumë komuna ndajnë mjete prej kategorisë Transfer tek OJQ për mbulimin e shpenzimeve rrjedhëse për shoqatat që veprojnë lokalisht dhe janë me detyra dhe qëllime speciale, prapë se prapë nuk ka angazhim për zhvillimin e metodologjisë për transfer të kompetencave.

Në lidhje me procedurat dhe mekanizmat e vendosura në bazë të të cilave ndahen mbështetje financiare për shoqatat prej buxhetit të komunës prej 19¹⁰ komunave vetëm 6 komuna i ndajnë mjetet për mbështetje të shoqatave prej buxhetit komunal nëpërmjet konkursit publik (Tabela nr.1). Komunat tjera punojnë në principin e parashtrimit të kërkesës nga ana e shoqatave dhe pa kritere të caktuara për ndarje, Këshilli sjell vendim. Me të dhënat se vetëm 7 komuna kanë zhvilluar kriteriume për ndarjen e mjeteve për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal, shihet qartë se ndarja e mjeteve është përgjithësisht jo transparente. Njëkohësisht, të dhënat tregojnë se edhe në 4 komuna, shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit të komunës, formalisht nuk kanë obligim të dorëzojnë raporte për mjetet e harxhuara. Kjo tregon se praktikat e mira për rritjen e transparencën dhe përgjegjësinë e komunave gjatë ndarjes së mjeteve për mbështetje të shoqatave nuk janë miratuar në më shumë se gjysmën e komunave të cilat janë të kyçura në analizë.

¹⁰ Shtip, Karbinci, Kocani, Ceshinovo-Obleshevo, Kercovë (me komunat e bashkangjitura Zajas, Oslomej, Drugovë dhe Vraneshtice), Pllasnica, makedonski Brod, Diber, Mavrove-Rostushe, Qender Zhupe, Struge, Manastir, Mogila, Novaci dhe Demir Hisar.

Ndryshimi në punën dhe praktikën në mes të komunave të ndryshme tregon mangësi në qasjen staregjiko planifikuese kah zhvillimi dhe qëndrueshmëria e shoqatave nga ana e institucioneve.

Sipas rezultateve nga analiza sasi të konsiderueshme të linjës buxhetore transfer tek OJQ, prej buxheteve të komunave u janë transferuar klubeve sportive. Në këtë mënyrë, publiku ndërton fotografi të gabuar për vlerën e mjeteve të cilat realisht transferohen tek shoqatat, e cila është shumë më e vogël në krahasim me vlerën më të cilat mbështëten klubet sportive lokale.

Në lidhje me ndryshimin në komuna urbane dhe rurale, përveç asaj se komunat rurale ndajnë numër më të madh të granteve sesa ato urbane, por në vlerë më të lartë, nuk ekzistojnë dallime të dukshme në përqindjen e mjeteve të transferuara për mbështetjen e shoqatave nga buxheti i komunës, as edhe në procedurat për ndarjen e tyre.

Komentet dhe reagimet e shoqatave prej katër rajoneve (Shtip, Manastir, Kërçovë dhe Dibër) për të dhënat e analizës përgjithësisht kanë të bëjnë me sasinë e kategorisë buxhetore Transfer tek OJQ në buxhetin komunal, edhe për shkak të faktit se në vitin 2013 në shumicën e komunave është zvogëluar. Shoqatat vlerësojnë se komunat nuk janë të interesuara për bashkëpunim afatgjat dhe efektiv me sektorin qytetar për atë shkak edhe është zvogëluar katëgoria buxhetore.

Tjetër vërejtje e shoqatave është se afirmimi i komunave kah disa shoqata të cilat fitojnë mjete prej buxhetit komunal, dhe lokalisht njihen si shoqata me anëtarë me përkatësi politike. Kjo duke shikuar kah jotransparenca e ndarjes së mejteve prej linjës buxhetore Transfer tek OJQ përfaqëson sfidë serioze për mënyrën e ndarjes dhe harxhimit të parave të qytetarëve nga ana e komunave.

Shoqatat reagojnë edhe në vet linjën Transfer tek OJQ, e cila tek disa komuna është e pasqyruar si shumë e përgjithshme në buxhet, gjegjësisht në të njejtën janë future edhe mjetet për përkrahjen e klubeve sportive etj. Me çka jepet fotografi e rejsme për shumën e planifikuar për mbështetjen e shoqatave. Në disa komuna¹¹ kjo kategori është e ndarë me çka qartë është caktuar se sa mjete janë planifikuar dhe harxhuar për shoqatat, e sa për qëllime tjera.

Shoqatat komntojnë edhe për njohuritë, eksperiencat dhe ekspertizat të anëtarëve të shoqatave të cilat nuk janë plotësisht apo aspak të shfrytëzuara prej përfaqësuesve të qeverive locale në të gjitha sektoret dhe njësitë. Edhe pse disa shoqata kanë nënshkruar Memorandum me komunat, përsëri të punësuarit në komuna, anëtarët e këshillave të komunës dhe kryetarët nuk i shfrytëzojnë resurset e shoqatave.

¹¹ Kërçovë, Zajas, Oslomej, Drugovë, Makedonski Brod.

4. Bashkëpunimi me njësitë e Vetqeverisjes Lokale gjatë hulumtimit

- Në rajonin e Kërçovës, procesi i mbledhjes së informatave të nevojshme për analizën realizohej ndërmjet bashkëpunimit të hapur dhe kualitativ me të gjitha komunat (Kërçovë, Zajas, Oslomej, Drugovë, Vraneshticë, Pllasnicë, Makedonski Brod).

- Në rajonin e Shtipit, procesi i mbledhjes së informatave të nevojshme për analizën realizohej ndërmjet bashkëpunimit të hapur dhe kualitativ me komunat Karbinci, Cesinovë-Obleshevë dhe Koçan, përderian në komunën e Shtipit edhe përkaj mundimeve që të fitohen informatat e nevojshme nëpërmjet takimeve dhe qasjes në dokumente, u dorëzua edhe kërkesë sipas Ligjit për qasje të lirë tek informatat me karakter publik, nëpërmjet së cilës u dorëzuan të dhënat e kërkuara.

- Në rajonin e Dibrës, procesi i mbledhjes së informatave të nevojshme për analizën realizohej ndërmjet bashkëpunimit të hapur dhe kualitativ në komunat Qendër Zhupë dhe Strugë. Prosesi i mbledhjes së të dhënave në komunën e Dibrës u realizua me bashkëpunim të pjesëshëm, të dhënat e dorëzuara nuk janë të plota. Përfaqësuesit e Komunës Mavrovë Rostushë aspak nuk bashkëpunuan dhe nuk i dhanë të dhënat e nevojshme.

- Në rajonin e Manastirit, procesi i mbledhjes së informatave të nevojshme për analizën realizohej ndërmjet bashkëpunimit të hapur dhe kualitativ në komunat Novaci dhe Demir Hisar. Në komunën Mogila, u dorëzua kërkesë sipas Ligjit për qasje të lirë të informatave me karakter publik, që pastaj të plotësohen të dhënat.

Procesi i mbledhjes së informatave në komunën e Manastirit u realizua me pengesa me çka u fituan të dhëna jot ë plota në lidhje me vitin 2013 edhe përkaj dorëzimit të kërkesës sipas Ligjit për qasje të lirë të informatave.

Si shkak është paraqitur se Raporti për përkrahje financiare të shoqatave të qytetarëve prej buxhetit të komunës së Manastirit për vitin 2013 është në përpunim dhe nuk është i miratuar nga ana e Këshillit të komunës. Në letërkëmbim është theksuar se do ta publikojnë pas miratimit çka është edhe praktikë reale e komunës së Manastirit.

5. Rekomandime

11. Të rritet sasia e kategorisë buxhetore – Transfere tek shoqatat në marrëdhënie me buxhetin e përgjithshëm të komunës si hap I patjetërsueshëm për përparimin e bashkëpunimit në mes të komunës dhe shoqatave. Më së paku 1% prej buxhetit të përgjithshëm të komunës të planifikohet për mbështetjen e shoqatave
12. Në procesin e planifikimit të buxhetit, posaçërisht kategoria transfer tek shoqatat të realizohen takime konsultative me përfaqësues të shoqatave.
13. Vendosja e programit për financimin e shoqatave me prioritet qartësisht të vendosura nga ana e komunës.
14. Ndarja e mjeteve të caktuara për shoqatat, nga mjetet e komunës të caktuara për klubet lokale sportive, gjegjësisht buxhetit për kategorinë -Transfer tek shoqatat, të ndahet prej mjeteve caktuara për klubet sportive lokale, dhe të njetat të mbështeten prej ndonjë kategorie tjetër.
15. Zhvillimi i një metodologjie të qartë për ndarjen e mjeteve nga buxheti i komunës për mbështetje të shoqatave, gjegjësisht zhvillimin e kriteriumeve dhe procedurave për përparimin e praktikave të ndarjes së mjeteve financiare shoqatave nga ana e komunave.
16. Përgaditja e një pyetësori dhe regullorjeje për financimin e shoqatave e cila do të ketë kriteriume të qarta për dorëzimin e projekt ideve dhe financimin e tyre (duke i përfshirë edhe formularët për propozime dhe mënyrën e sjelljes së raporteve).
Kjo do të sjell deri tek zmadhimi i qëndrueshmërisë së shoqatave. Njëkohësisht, në mënyrë afatgjate do të përmirësohet procesi i evaluimit, monitorimit dhe raportimit për projektet dhe aktivitetet e kryera të shoqatave nga ana e komunave të sigurohet transparencë dhe përgjegjësi në harxhimin e parave publike, si dhe funksionaliteti në punën e komunave
17. Komunitat të publikojnë thirrje publike për dorëzimin e kërkesave (propozim ide, aktivitete programore, inicijativa, aksione të përbashkëta) për mbështetjen e shoqatave prej buxhetit të komunës.
18. Në komisionet për ndarjen e mjeteve për mbështetjen e shoqatave prej buxhetit komunal të kyçen edhe përfaqësues të shoqatave.
19. Zhvillimi i metodologjisë për transfer të kompetencave prej NjVL tek shoqatat.
20. Komunitat, është e nevojshme që të kenë ngritur një bazë të të dhënave, rregullisht të azhuruara për të gjitha shoqatat të cilat aktivisht veprojnë në komuna.

6. Informata plotësuese

- Shembull i pyetësorit sipas të cilit mblidheshin të dhënat
- Annex 1/2 – Të dhëna detale për komunitat

PYETËSOR PËR NJVL

Komuna _____
Udhëhqës i sektorit/njesisë: _____
Pyetësorin e plotësoi:
Kontakt: tel _____ , e-mail _____

1. A ndan komuna mjete financiare për mbështetjen e shoqatave lokale prej buxhetit të saj?

Po Jo

2. Sa mjete prej buxhetit të komunës janë planifikuar për përkrahje financiare të drejtpërdrejta për shoqatat lokale?

Viti	MKD në vit	% prej buxheut komunal
Viti 2012		
Viti 2013		

3. Sa mjete prej buxhetit së komunës suaj janë transferuar për përkrahje direkte të shoqatave lokale?

Viti	MKD në vit	Numri i shoqatave që kanë fituar mjete
Viti 2012		
Viti 2013		

3 a) Nëse nuk keni transferuar. Spjegoni shkakun.

4. Sa mjete janë transferuar për shoqatat lokale prej kategorive tjera buxhetore?

Viti	MKD në vit	Emri ishoqatave të cilat kanë fituar mjete
Viti 2012		
Viti 2013		

4 a) Nëse nuk janë transferuar, tregoni shkakun.

5. Shoqatat për të cilat komuna ka siguruar/transferuar mjete?

Viti	Emri i shoqatës	Emri i projektit / aktivitetit	MKD
2012			
2013			

6. A shpërndahen mjetet e parapara për shoqata të qytetarëve nëpërmjet konkursit/shpalljes publike?

Po **Jo**

7. A keni kritere të shkruara për ndarjen e mjeteve të parapara për përkrahjen e shoqatave qytetare?

Po **Jo**

8. Shoqatat qytetare që kanë fituar mjete a kanë obligim që të dorëzojnë raport?

Po **Jo**

Nëse përgjigja është PO

9. Sa herë gjatë realizimit kanë obligim të sjellin raport?

ANNEX 1

1. Mënyra e shpërndarjes së mjetve nga buxheti il komunave për përkrahje të shoqatave dhe fondacioneve

Tabela nr. 1

Shtip	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet ndahen nëpërmjet konkursit publik me kriteriume të zhvilluara për shpërndarje. Shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit komunal kanë obligim që të dorëzojnë raport narativ dhe financiar, pas mbarimit të aktiviteteve.
Karbinci	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal Mjetet ndahen nëpërmjet konkursit publik pa kriteriume të zhvilluara për shpërndarje. Por për shkak të mos ekzistimit të shoqatave aktive në komunaë, mjetet nuk ndahen.
Koçan	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet ndahen nëpërmjet konkursit publik me kriteriume të zhvilluara për shpërndarje. Shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit komunal kanë obligim që të dorëzojnë raport narativ dhe financiar , pas mbarimit të aktiviteteve..
Ceshinovë-Obleshevë	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet ndahen nëpërmjet konkursit publik me kriteriume të zhvilluara për shpërndarje. Shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit komunal kanë obligim që të dorëzojnë raport narativ dhe financiar, pas mbarimit të aktiviteteve.
Kërçovë (Zajas, Oslomej, Drugovë, Vraneshticë)	Komunat Kërçovë, Zajas, Oslomej dhe Drugovë çdo vjet planifikojnë mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Komuna Vraneshticë nuk planifikon, as nuk ndan mjete për përkrahjen e shoqatave nga buxheti komunal Mjetet të cilan ndahen nga buxheti komunal nuk ndahen nëpërmjet konkursit publik, as edhe sipas kriteriumeve të zhvilluara. Në komunën Oslomej, mjetet ndahen sipas rregullores dhe shoqatat janë të obliguara të dorëzojnë raport përfundimtar. Bo Komuna e Kërçovës në vitin 2012, kërkesat e shoqatave I kontrollon dhe I rekomandon për financim Komisioni për financa dhe buxhet. Në vitin 2013 sipas rregullores së zhvilluar Kryetari I komunës I rekomandon këshillit se sad he cilave shoqata do tu ndahen mejte prej buxhetit komunal. Mjetet ndahen me kërkesë prej shoqatave.
Plasnicë	Komuna nuk bën planifikim vjetor për mjete financiare për përkrahje të shoqatave prej buxhetit komunal.
Makedonski Brod	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet nuk ndahen nëpërmjet konkursit publik, as edhe sipas kriteriumeve të zhvilluara për ndarje. Kryetari I komunës është I autorizuar prej këshillit, të vendosën për të gjitha kërkesat të cilat vijnë tek këshilli nga persona fizik dhe juridik dhe janë prej mjeteve të vogla financiare. Shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit komunal janë të detyruara të dorëzojnë raport tek NjVL, por shoqatat nuk dorëzojnë raport..

Dibër	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet nuk ndahen nëpërmjet konkursit publik, por sipas kriteriumeve të zhvilluara për ndarje. Shoqatat që kanë fituar mbështetje financiare nuk kanë obligim që të dorëzojnë raport.
Mavrovë-Rostush	Nuk ka të dhëna
Qendër Zhupë	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet nuk ndahen nëpërmjet konkursit publik, por sipas kriteriumeve të zhvilluara për ndarje. Shoqatat që kanë fituar mbështetje financiare nuk kanë obligim që të dorëzojnë raport.
Strugë	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet ndahen nëpërmjet konkursit publik me kriteriume të zhvilluara për shpërndarje. Shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit komunal kanë obligim që të dorëzojnë raport narativ dhe financiar , pas mbarimit të aktiviteteve.
Manastir	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet ndahen nëpërmjet konkursit publik me kriteriume të zhvilluara për shpërndarje. Shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit komunal kanë obligim që të dorëzojnë raport narativ dhe financiar , pas mbarimit të aktiviteteve.
Mogila	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet nuk ndahen nëpërmjet konkursit publik por me kriteriume të zhvilluara për shpërndarje. Shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit komunal kanë obligim që të dorëzojnë raport narativ dhe financiar , pas mbarimit të aktiviteteve.
Novaci	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet nuk ndahen nëpërmjet konkursit publik dhe nuk ekzistojnë kriteriume të zhvilluara për shpërndarje. Shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit komunal kanë obligim që të dorëzojnë raport narativ dhe financiar , pas mbarimit të aktiviteteve.
Demir Hisar	Komuna çdo vjet planifikon mjete financiare për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal. Mjetet nuk ndahen nëpërmjet konkursit publik dhe nuk ekzistojnë kriteriume të zhvilluara për shpërndarje. Shoqatat të cilat kanë fituar mjete prej buxhetit komunal kanë obligim që të dorëzojnë raport narativ dhe financiar , pas mbarimit të aktiviteteve.

2. Të dhëna kuantitative nga hulumtimi

- Sa është përqindja e mjeteve të planifikuara për aktivitete të shoqatave prej buxhetit të përgjithshëm të komunave?

Tabela nr. 2	0 - 1%	1,01 – 2%	2,01 – 3%	3,01 - 4%	4,01% - <
2012	13	1		1	
2013	13	1	1		

- Në vitin 2012. Përqindje më të madhe për përkrahje të aktiviteteve të shoqatave prej buxhetit të përgjithshëm ka komuna e Mogilës me 3,14 %, përderisa përqindje më të vogël ka komuna e Makedonski Brodit me 0,04% prej buxhetit të përgjithshëm.

- Në vitin 2013. Përqindje më të madhe për përkrahje të aktiviteteve të shoqatave prej buxhetit të përgjithshëm ka komuna e Mogilës me 2,54 %, përderisa përqindje më të vogël ka komuna e Makedonski Brodit me 0,04% prej buxhetit të përgjithshëm.





Tabela nr. 2a	0 - 1%	1,01 – 2%	2,01 – 3%	3,01 - 4%	4,01% - <
Komuna Urbane	7				
Komuna Rurale	6	1	1	1	



- Prej komunave urbane, përqindje më të madhe prej buxhetit të komunës të planifikuar për përkrahje të shoqatave ka komuna e Dibrës me 1,22%, përderisa përqindje më të vogël ka komuna e Makedonski Brod me 0,04% prej buxhetit të përgjithshëm komunal.


- Prej komunave rurale, përqindje më të madhe prej buxhetit të komunës të planifikuar për përkrahje të shoqatave ka komuna e Mogilës me 3,14%, përderisa përqindje më të vogël kanë komuna e Zajac dhe Drugovo me 0,07% nga buxheti i përgjithshëm komunal.

- Komunitat Vraneshtica dhe Plasnica, nuk planifikojnë përkrahje financiare për shoqatat në buxhetin e komunave. Општините Вранештица и Пласница не планираат финансиска поддршка за здруженија во општинските буџети.

- Nuk egziston ndonjë ndryshim i madh në mes komunave urbane dhe rurale sa i përket përqindjes së mjeteve të planifikuara për përkrahjen e shoqatave prej buxhetit komunal.

- Sa mjete buxhetohen nga kategoria buxhetore për shoqatat (MKD)?


tabela nr.3	0-1.000.000	1.000.001-2.000.000	2.000.001 – 3.000.000	3.000.001 – 4.000.000	5.000.000 - <
2012	10	3	1	1	1
2013	10	3	1	1	1



- Në vitin 2012, më së shumti mjete për përkrahje të shoqatave prej buxhetit të përgjithshëm komunal ka komuna e Strugës – 5 005 000,00 MKD kurse më së paku komuna Qendra e Zhupës– 40 000,00 MKD prej buxhetit të përgjithshëm komunal.

- Në vitin 2013, më së shumti mjete për përkrahje të shoqatave prej buxhetit të përgjithshëm komunal ka komuna e Strugës – 4 813 000,00 MKD, më së paku komuna Drugovo – 30 000,00 MKD nga buxheti I përgjithshëm komunal.

	0-1.000.000	1.000.001-2.000.000	2.000.001 – 3.000.000	3.000.001 – 4.000.000	5.000.000 - <
Komuna Urbane	1	3	1	1	2
Komuna Rurale	9				



- Prej komunave rurale më së shumti mjete për përkrahje të shoqatave prej buxhetit të përgjithshëm komunal ka komuna e Strugës - 5 005 000,00 MKD, më pak komuna Demir Hisar– 100 000,00 MKD prej buxhetit të përgjithshëm komunal.


- Prej komunave rurale më së shumti mjete për përkrahje të shoqatave prej buxhetit të përgjithshëm komunal ka komuna e çeshinovo-Obleshevë - 1 170 000,00 00 MKD, më pak komuna Drugovë– 30 000,00 MKD prej buxhetit të përgjithshëm komunal.

- Komuna Vraneshtica dhe Plasnica nuk planifikojnë përkrahje financiare për shoqatat në buxhetin e komunës.

- Në linjën buxhetore për përkrahjen e shoqatave numri më I madh I komunave janë të buxhetuara nga 1.000.000 MKD por interesant është se në këtë kornizë lëvizin 9 komuna rurale dhe një urbane. Korniza buxhetore e komunave urbane është më e madhe sepse njëra prej komunave buxheton më shumë se 5.000.000 mkd.

• **Sa mjete janë harxhuar nga linja buxhetore për shoqatat (MKD)**


	0-1.000.000	1.000.001-2.000.000	2.000.001 – 3.000.000	3.000.001 – 4.000.000	5.000.000 - <
2012	11		2	1	
2013	9	1	1	1	



- Në vitin 2012, komuna e Strugës ka transferuar më së shumti mjete financiare – 3 729 303,00 MKD prej buxhetit të komunës për përkrahje të shoqatave, kurse më së pakti komuna Qendër Zhupë– 12 000,00 MKD.

- Në vitin 2013 komuna e Strugës ka transferuar më së shumti mjete financiare – 2 515 485,00 MKD prej buxhetit të komunës për përkrahje të shoqatave, kurse më së pakti komuna Shtip – 20 000,00 MKD.

	0-1.000.000	1.000.001-2.000.000	2.000.001 – 3.000.000	3.000.001 – 4.000.000	5.000.000 - <
Komuna urbane	4		2	1	
Komuna rurale	6	1			



- Prej komunave urbane , komuna e Strugës ka transferuar më së shumti mjete financiare – 3 729 303,00 MKD prej buxhetit të komunës për përkrahje të shoqatave, më së paku komuna Shtip – 20 000,00 MKD.


- Prej komunave rurale, komuna e çeshinovo-Obleshevo ka transferuar më së shumti mjete financiare 1 017 000,00 MKD prej buxhetit të komunës për përkrahje të shoqatave, a më së paku Komuna Qendër Zhupë– 12 000,00 MKD.

- Komuna Karbinci, Drugova, Vraneshtica dhe Plasnicë nuk kanë transferuar mjete prej buxhetit komunal për shoqatat.

- Prej linjës buxhetore Transfer tek OJQ prej buxhetit komunal për përkrahje të shoqatave në numrin më të madh të komunave janë harxhuar deri në 1.000.000 MKD.


- **Sa përqind prej mjeteve të buxhetuara për përkrahje të shoqatave janë ndarë - transferuar shoqatave?**

	0 - 30%	30,01-50%	50,01– 80%	80,01- 100%	100% - <
2012	5	2	6	2	1
2013	7	0	5	2	1



• Sa është mesatarja e lartësisë së granteve (MKD)?

Tabela nr.6	0-10.000	10.001 – 50.000	50.001-100.000	100.001-300.000	300.001 - <
2012	87	153	12	6	3
2013	26	61	12	5	1




- Në vitin 2012, grantin më të madh të ndarë prej buxhetit komunal për përkrahje të shoqatave është 1 125 000,00 MKD nga komuna e Strgës Qendrës për persona me pengesa intelektuale “Poraka Nova”– Struga.

Granti më i vogël i ndarë prej buxhetit komunal për përkrahje të shoqatave është 3 000,00 MKD në komunën Novaci për më shumë shoqata për qëllime të ndryshme.

- Në vitin 2013, grantin më të madh të ndarë prej buxhetit komunal për përkrahje të shoqatave është 802 000,00 MKD nga komuna çeshinovo-Obleshevo për edukim të fëmijëve të moshës parashkollore.

Granti më i vogël i ndarë prej buxhetit komunal për përkrahje të shoqatave është 3 000,00 MKD në komunën Novaci për qëllime të ndryshme.

Tabela nr .6a	0-10.000 MKD	10.001 – 50.000 MKD	50.001–100.000 MKD	100.001–300.000 MKD	300.001 - < MKD
Komuna urbane	61	139	15	8	
Komuna rurale	53	70	15	5	4



- Në komunat rurale, granti më i madh i ndarë prej buxhetit komunal për përkrahje të shoqatave është 1 125 000,00 MKD Qendrës për persona me pengesa intelektuale „Poraka Nova“ – Strugë.

Granti më i vogël i ndarë prej buxhetit komunal për përkrahje të shoqatave është 4 000,00 MKD në komunën e Strugës për SHQ SHQ „Klubi demokratik“.

- Në komunat rurale, granti më i madh i ndarë prej buxhetit komunal për përkrahje të shoqatave është 802 000,00 MKD nga komuna çeshinovo-Obleshevo për edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore .

Granti më i vogël i ndarë prej buxhetit komunal për përkrahje të shoqatave është 3 000,00 MKD në komunën Novaci për qëllime të ndryshme.

- Numri më i madh i granteve që janë ndarë janë me lartësi prej 10.000 dhe 50.000 MKD. Komunat rurale ndajnë numër më të vogël të grantve por me shumë më të mëdha.

• **Sfera e veprimit të shoqatave të cilëve u janë ndarë mjete prej buxhetit komunal?**

Tabela nr.7

nr.rend.	Sfera e veprimit	Numri i organizatave
16.	Kulturë dhe art	45
17.	Demokraci dhe të drejtat e njeriut	39
18.	Të tjera	36
19.	sport, hobi, rekreacion	35
20.	Veçori kulturore	30
21.	fëmijë, të rinj, studentë	18
22.	Persona me nevoja të veçanta	17
23.	Organizata profesionale	17
24.	Gra	14
25.	Punë sociale dhe humanitare	12
26.	Mjedisi jetësor	10
27.	Zhvillimi i shoqërisë civile	9
28.	Zhvillim rural	6
29.	Persona të moshuar	4
30.	Arsim dhe shkencë	2

ANNEX 2

1. Të dhëna detale për komunat

- Sa mjete prej buxhetit të komunës janë planifikuar për përkrahje financiare direkte për mbështetjen e shoqatave locale?

Nr.rend.	Komuna	MKD 2012	%	MKD 2013	%
1	Shtip	1 300 000,00	0,21	800 000,00	0,13
2	Karbinci	200 000,00	0,40	200 000,00	0,40
3	Koçan	1 200 000,00	0,52	1 200 000,00	0,52
4	Ceshinovo – Obleshevo	855 000,00	1,08	1.170 000,00	1,33
5	Kërçovë	1 540 000,00	0,29	1 295 000,00	0,18
	Zajas	91 000,00	0,10	70 000,00	0,07
	Oslomej	320 000,00	0,31	360 000,00	0,31
	Drugovo	150 000,00	0,34	30 000,00	0,07
	Vraneshticë	00	00	00	00
6	Pillasnicë	00	00	00	00
7	Makedonski Brod	410 000,00	0,04	485 000,00	0,04
8	Dibër	3 000 000,00	1,20	3 400 000,00	1,22
9	Mavrovë – Rostushë	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna
10	Qendër zhupë	40 000,00	0,18	45 000,00	0,22
11	Strugë	5 005 000,00	0,90	4 813 000,00	0,80
12	Manastir	3 700 000,00	0,47	4 600 000,00	0,57
13	Mogila	850 000,00	3,14	780 000,00	2,54
14	Novaci	400 000,00	nuk ka të dhëna	400 000,00	nuk ka të dhëna
15	Demir Hisar	100 000,00	0,20	135 000,00	0,30

• Sa mjete prej buxhetit të komunës janë transferuar si mbështetje direkte financiare shoqatave?

Nr.rend.	Komuna	MKD 2012	Numri i shoqatave që kanë fituar mjete	MKD 2013	Numri i shoqatave që kanë fituar mjete
1	Shtip	889 795,00	15	20 000,00	1
2	Karbinci	0	0	0	0
3	Koçan	839 070,00	20	747 304,00	18
4	çeshinovo – Obleshevo	693 000,00	4	1 017 000,00	3
5	Kërçovë	484 847,00	14	760 152,00	13
	Zajas	21 000,00	2	00	00
	Oslomej	146 375,00	4	41 000,00	3
	Drugovo	00	/	00	/
	Vraneshticë	00	/	00	/
6	Pllasnicë	00	/	00	/
7	Makedonski Brod	118 340,00	3	72 000,00	2
8	Dibër	2 300 000,00	12	2 400 000,00	13
9	Mavrovë – Rostushë	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna
10	Qendër zhupë	12 000,00	1	0	0
11	Strugë	3 729 303,00	26	2 515 485,00	20
12	Manastir	2 749 000,00	130	nuk ka të dhëna	68
13	Mogila	680 000,00	4	625 150,00	5
14	Novaci	310 300,00	29	725 000,00	34
15	Demir Hisar	56 000,00	2	90 000,00	2

• Përqindja e mjeteve të ndara-transferuara për përkrahjen e shoqatave prej mjeteve të buxhetuara

		Planifikimi 2012	Të harxhuara 2012	2012	Planifikimi 2013	Të harxhuara 2013	2013
Nr.rend.	Komuna	MKD 2012	MKD 2012	%	MKD 2013	MKD 2013	%
1	Shtip	1 300 000,00	889 795,00	68,45	800 000,00	20 000,00	2,5
2	Karbinçi	200 000,00	0	00	200 000,00	0	00
3	Koçan	1 200 000,00	839 070,00	69,92	1 200 000,00	747 304,00	62,27
4	çeshinovo – Obleshevo	855 000,00	693 000,00	81,05	1.170 000,00	1 017 000,00	86,92
5	Kërçovë	1 540 000,00	484 847,00	31,48	1 295 000,00	760 152,00	58,69
	Zajas	91 000,00	21 000,00	23,07	70 000,00	00	00
	Oslomej	320 000,00	146 375,00	45,74	360 000,00	41 000,00	11,38
	Drugovo	150 000,00	00	00	30 000,00	00	00
	Vraneshticë	00	00	00	00	00	00
6	Pillasnicë	00	00	00	00	00	00
7	Makedonski Brod	410 000,00	118 340,00	28,86	485 000,00	72 000,00	14,84
8	Dibër	3 000 000,00	2 500 000,00	83,33	3 400 000,00	2 400 000,00	70,58
9	Mavrovë – Rostushë	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna		nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna	
10	Qendër zhupë	40 000,00	12 000,00	30,00	45 000,00	0	00
11	Strugë	5 005 000,00	3 729 303,00	74,51	4 813 000,00	2 515 485,00	52,26
12	Manastir	3 700 000,00	3 700 000,00	100,00	4 600 000,00	nuk ka të dhëna	nuk ka të dhëna
13	Mogila	850 000,00	680 000,00	80,00	780 000,00	625 150,00	80,15
14	Novaci	400 000,00	310 300,00	77,57	400 000,00	725 000,00	181,25
15	Demir Hisar	100 000,00	56 000,00	56,00	135 000,00	90 000,00	66,66

- **Shkaqe për mos ndarjen e mjeteve për mbështetjen e shoqatave prej buxhetit të komunës.**

Nr.rend.	Komuna	Shkaqe
1	Karbinci	Në teritorin e komunës së karbincit nuk ka shoqata qytetare të cilat veprojnë në mënyrë active , as edhe nuk janë të kyçura në ndonjë project.
2	Oslomej	2012 dhe 2013 – për shkak të mungesës së mjeteve në buxhetin e komunës Oslomej, mjetet e planifikuara nuk janë realizuar.
	Drugovë	2012- Mungesa e mjeteve financiare 2013- Mungesa e mjeteve financiare, para bashkimit me komunën e Kërçovës 09.05.2013
3	Pllasnicë	2012 и 2013 – Për shkak të llogarisë së bllokuar të Komunës Pllasnica nuk ka kryer asnjë ndarje financiare prej buxhetit të saj për shoqatat lokale
4	Makedonski Brod	2012-kërkesa e dërguar prej shoqatës Garut në vitin 2011 e cila pastaj ka pushuar së funksionuari. Për shkak të mungesës së mjeteve financiare mjetet e planifikuara nuk janë realizuar 2013- Për shkak të mungesës së mjeteve, dy shoqatave (Klubi I peshkatarëve sportiv „Klen“ dhe KF „Mirçe Acev“ M. Brod) nuk u janë transfear mjete
5	Qendër Zhupë	Mungesë të mjeteve financiare në atë periudhë.

- **Sa mjete u janë transferuar shoqatave lokale (organizatave qytetare) prej kategorive tjera të buxhetit komunal?**

Nr.rend.	Komuna	MKD në vit	Emir I shoqatave që kanë fituar mjete
1	Kërçove	95 420,00	Asambli „Tanec“ SHKA „Koço RAcin“ Kërçovë Shoqata „Inspaler“Kërçovë Shoqata e personave të verbër Kërçovë
	Oslomej	36 375,00	Shoqata „Skalla Skupi“, Shkup
2	Makedonski Brod	170 340,00	Shoqata e grave „LUNA“, M.Brod SHKA „7 Shtatori“ M. Brod Shoqata lidhja komunale e sporteve shkollore
3	Dibër	200 000,00	Festivali i teatrit shqiptar në MK.
4	Manastir	951 000,00	nuk ka të dhëna

7. Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Metodologjia.....	5
3. Analiza	6
4. Bashkëpunimi me Njësitë e Vetqeverisjes Lokale gjatë hulumtimit	8
5. Rekomandime	9
6. Informata plotësuese.....	10
ANNEX 1.....	12
ANNEX 2.....	19
7. Përmbajtja.....	23

ФОНДАЦИЈА
ЗА РАЗВОЈ НА
ПОКАПНАТА
ЗАЕДНИЦА



Analysis of the practices for funds allocation from the municipal budgets to associations in the regions of Shtip, Kichevo, Debar and Bitola



This publication was made possible with support from the American people delivered through the U.S. Agency for International Development (USAID). The contents are the responsibility of the author and do not necessarily reflect the opinion of USAID or the Government of United States of America.

Publication title:

Analysis of the practices for funds allocation from the municipal budgets to associations in the regions of Shtip, Kichevo, Debar and Bitola

Publisher:

Local Community Development Foundation – Shtip

Authors:

Violeta Nicheva Tikveshanska
Elizabeta Risteska
Shuip Marku
Dejan Dodovski

Lecturer:

Violeta Karagunova

English translation:

Biljana Kolarova

Design and print:

Motiv Plus – Shtip

Circulation: 500

Shtip, 2014

1. Introduction

This paper contains the results from the survey for funds allocation from the municipal budgets and usage of these funds by the associations, especially the budget item – Transfer to NGO in the period of 2012 and 2013 in 15 municipalities in the Republic of Macedonia: Shtip, Karbinici, Kochani, Cheshinovo-Obleshevo, Kichevo, (along with the newly added communities of Zajas, Oslomej, Drugovo and Vraneshtica), Plasnica, Makedonski Brod, Debar, Mavrovo-Rostusa, Centar Zupa, Struga, Bitola, Mogila, Novaci and Demir Hisar.

The goal of this analysis is to emphasize the fact that the associations' sustainability and the transparency and accountability in the process of spending public money, should not be left only on the will of the local authorities.

This paper, arguments the shallow approach of the local authorities in the process of planning and allocation of funds to the local associations.

The analysis covers various issues in direction of improving the current situation of the financial and budgetary practices of the Units of Local Government in the process of funds allocation to local associations.

2. Methodology

In the period of January – March 2014, Local Community Development Foundation – Shtip, Centre for sustainable community development – Debar, Centre for community Development – Kichevo and Youth Cultural Centre – Bitola, conducted a survey for determining the current situation of the financial and budgetary practices of the Units of Local Government for funds allocation to local associations in the years of 2012 and 2013 in 15¹² municipalities in Republic of Macedonia: Shtip, Karbinci, Kochani, Cheshinovo-Obleshevo, Kichevo (along with the attached communities of Zajas, Oslomej, Drugovo, Vraneshtica)¹³, Plasnica, Makedonski Brod, Debar, Mavrovo-Rostusha, Centar Zupa, Struga, Bitola, Mogila, Novaci and Demir Hisar.

The selection of the municipalities was made according to basic characteristics of the municipalities: region, size, urban/rural and ethnic background of the population.

In the four regions (Shtip, Kichevo, Debar and Bitola) the survey was conducted by four local coordinators following previously prepared questionnaires with defined questions and developed implementation plan.

